KIRFN Interpretimi 2
Aksionet e Anëtarëve në Njësitë Ekonomike Kooperativa dhe Instrumente të Ngjashme

Referenca

- SNRF 9 *Instrumentet Financiarë*
- SNRF 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*
- SNK 32 *Instrumentet financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese dhe Paraqitja* (rishikuar në 2003)[1]

Historiku

1 Kooperativat dhe njësitë e tjera të ngjashme formohen nga grupe njerëzish për të përmbushur nevoja ekonomike ose sociale të përbashkëta. Ligjet kombëtare në mënyrë tipike përkufizojnë një kooperativë si një shoqëri e cila përpiqet të promovojë përparimin ekonomik të anëtarëve nëpërmjet një veprimtarie biznesi të përbashkët (parimi i vetë-ndihmës). Interesat e anëtarëve në një kooperativë shpeshherë marrin formën e aksioneve të anëtarëve, pjesë ose të ngjashme, dhe u referohemi më poshtë si 'aksione të anëtarëve'.

2 SNK 32 krijoi parimet për klasifikimin e instrumenteve financiare si detyrime financiare apo kapital. Veçanërisht, këto parime aplikohen në klasifikimin e instrumenteve të kthyeshëm të aksioneve (puttable) të cilat lejojnë zotëruesin të kthejë këto instrumente tek emetuesi për mjete monetare ose ndonjë instrument tjetër financiar. Është i vështirë aplikimi i këtyre parimeve tek anëtarët e njësisë ekonomike tip Kooperative dhe instrumenteve te ngjashme. Disa nga anëtarët e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit kanë kërkuar ndihmë për të kuptuar se si parimet në SNK 32 zbatohen për aksionet e anëtarëve dhe instrumentet e ngjashme që kanë veçori të caktuara, dhe rrethanat në të cilat këto veçori ndikojnë në klasifikimin si detyrime ose kapital.

Objekti

3 Ky interpretim aplikohet për instrumente financiare brenda objektit të SNK 32, duke përfshirë instrumentet financiare të emetuara për anëtarët e njësive tip kooperativa të cilat janë evidencë e interesit zotërues të anëtarëve në njësinë ekonomike. Interpretimi nuk aplikohet për instrumentet financiare të cilat do të ose mund të shlyhen nëpërmjet instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë ekonomike.

Çështja

4 Shumë instrumente financiare, duke përfshirë aksionet e anëtarëve, kanë karakteristikat e kapitalit, duke përfshirë këtu të drejtat votuese si dhe të drejtat për të marrë pjesë në shpërndarjet e dividentëve. Disa instrumente financiare i japin zotëruesit të drejtën për të kërkuar riblerje e tyre përkundrejt mjeteve monetare apo ndonjë aktivi tjetër financiar, por mund të përfshijnë ose të jenë subjekt kufizimesh në lidhje me faktin nëse instrumentet financiare do të riblihen. Si duhet të vlerësohen kushtet e riblerjes në mënyrë që të përcaktohet nëse instrumentet financiare duhet të klasifikohen si detyrim apo kapital?

Konsensusi

5 E drejta kontraktuale e zotëruesit të një instrumenti financiar (duke përfshirë aksionet e anëtarëve në njësitë tip kooperativa) për të kërkuar riblerje nuk e bën të detyrueshme, në vetvete, që instrumenti financiar të klasifikohet si detyrim financiar. Përkundrazi, njësia duhet të marrë në konsideratë të gjitha kushtet e instrumenteve financiare në përcaktimin e klasifikimit të tyre si një detyrim financiar apo kapital. Këto kushte përfshijnë ligjet përkatëse lokale, rregulloret dhe statutin qeverisës së njësisë në fuqi në ditën e

[1] Në gusht 2005 SNK 32 u ndryshua në SNK 32 *Instrumentet financiare*: *Paraqitja*. Në shkurt 2008, BSNK ndryshoi SNK 32 duke kërkuar që instrumentet financiarë që gëzojnë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e paragrafëve 16A dhe 16B ose paragrafëve 16C dhe 16D të SNK 32 të klasifikohen si instrumenta të kapitalit të vet.

klasifikimit, por jo ndryshime të ardhshme të cilat parashikohen për ligjet, rregulloret dhe statutin qeverisës në fjalë.

6 Aksionet e anëtarëve që mund të klasifikoheshin si të kapitalit të vet nëse anëtarët nuk kishin të drejtën për të kërkuar shlyerje, janë të kapital i vet nëse janë të pranishme kushtet e përshkruara në paragrafët 7 dhe 8 ose aksionet e anëtarëve kanë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32. Depozitat e kërkueshme, përfshirë llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimit dhe kontrata të ngjashme që krijohen kur anëtarët veprojnë si klientë janë detyrime financiare të njësisë ekonomike.

7 Aksionet e anëtarëve konsiderohen si kapital nëse njësia ka të drejtën e pakushtëzuar për të refuzuar riblerjen e aksioneve të anëtarëve.

8 Ligjet vendore, rregulloret ose statuti qeverisës i njësisë mund të vendosë ndalime të tipeve të ndryshme në riblerjen e aksioneve të anëtarëve, p.sh. ndalime të pakushtëzuara ose ndalime të bazuara në kritere të likuiditetit. Nëqoftëse riblerja është ndaluar në mënyrë të pakushtëzuar nga ligjet vendore, rregulloret ose statuti qeverisës i njësisë, aksionet e anëtarëve janë kapital. Megjithatë, nene të ligjeve vendore, të rregulloreve, ose të statutit qeverisës së njësisë, të cilat ndalojnë riblerjen vetëm nëse plotësohen (ose nuk plotësohen) kushte të caktuara, si p.sh. kufizime likuiditeti, nuk na bëjnë të konsiderojmë aksionet e anëtarëve si kapital.

9 Një ndalim i pakushtëzuar mund të jetë absolut, në kuptimin që ndalohet çdo lloj shlyerjeje. Një ndalim i pakushtëzuar mund të jetë i pjesshëm, në atë që ai ndalon shlyerjen e aksioneve të anëtarëve po qe se shlyerja do të mund të shkaktonte rënie të numrit të aksioneve të anëtarëve ose rënie të shumës së kapitalit të paguar nga aksionet e anëtarëve poshtë një niveli të caktuar. Aksionet e anëtarëve që tejkalojnë ndalimin ndaj shlyerjes janë detyrime përveç rasteve kur njësia ekonomike ka një të drejtë të pakushtëzuar për të refuzuar shlyerjen siç përcaktohet në paragrafin 7 ose kur aksionet e anëtarëve gëzojnë të gjitha tiparet dhe kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32. Në disa raste numri i aksioneve ose shuma e kapitalit të paguar që është objekt i një ndalimi shlyerjeje mund të ndryshojë herë pas here. Një ndryshim i tillë në ndalimin për shlyerje çon një transferim mes detyrimit financiar dhe kapitalit të vet.

10 Gjatë njohjes fillestare, njësia vlerëson detyrimin financiar për riblerjen me vlerën e drejtë. Në rastin e aksioneve të anëtarëve të cilat mund të riblihen, njësia mat vlerën e drejtë të detyrimit financiar për riblerje me jo më pak se maksimumin e shumës së pagueshme sipas neneve të riblerjes në statutin e saj qeverisës, ose ligjin e aplikueshëm duke e skontuar atë shumë prej datës së parë në të cilën ajo mund të kërkohet të paguhet (shiko shembullin 3).

11 Siç kërkohet nga paragrafi 35 i SNK 32, shpërndarjet tek zotëruesit e instrumenteve të kapitalit neto njihen drejtpërdrejt në kapitalin neto, neto nga çdo përfitim i lidhur i tatimit mbi të ardhurat. Interesi, dividendët dhe kthimet e tjera që lidhen me instrumentet financiare të klasifikuara si detyrime financiare janë shpenzime, pavarësisht nga fakti nëse këto shuma të paguara karakterizohen ligjërisht si dividendë, interesa ose ndryshe.

12 Shtojcë, e cila është një pjesë integrale e konsensusit, jep shembuj të aplikimit të këtij konsensusi.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

13 Kur një ndryshim në ndalimin e riblerjes çon në një transferim mes detyrimeve financiare dhe kapitalit, njësia jep veçmas informacion shpjegues për shumën, kohën, dhe arsyen për transferimin.

Data e hyrjes në fuqi

14 Data e hyrjes në fuqi dhe kërkesat e periudhës kalimtare të këtij interpretimi janë të njëjta me ato të SNK 32 (sipas rishikimit në 2003). Një njësi ekonomike aplikon këtë interpretim për periudha vjetore duke filluar në ose pas 1 janar 2005. Nëse një njësi ekonomike e aplikon këtë interpretim për një periudhë që fillon përpara 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Ky interpretim aplikohet në mënyrë retrospektive.

14A Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet në paragrafët 6, 9, A1 dhe A12 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton *Instrumentet financiarë të kthyeshëm dhe detyrimet që lindin në likuidim* (Ndryshime në SNK 32 dhe SNK 1), publikuar në shkurt 2008, për një periudhë më të hershme, ndryshimet në paragrafët 6, 9, A1 dhe A12 duhet të zbatohen edhe për këtë periudhë më të hershme.

15 [Fshirë]

 © Fondacioni i SNRF-ve

16 SNRF 13, i publikuar në maj 2011, ndryshoi paragrafin A8. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.

17 *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2009-2011,* të publikuara në maj 2012, kanë ndryshuar paragrafin 11. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet* [2] për periudhat që fillojnë në 1 janar 2013 e më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë ndryshim të SNK 32 si pjesë e *Ciklit të Përmirësimeve Vjetor 2009-2011* (të publikuara në maj 2012) për një periudhë më të hershme, ndryshimi në paragrafin 11, do të zbatohet edhe për periudhën më të hershme.

18 [Fshirë]

19 SNRF 9, i publikuar në korrik 2014, ka ndryshuar paragrafët A8 dhe A10 dhe ka fshirë paragrafët 15 dhe 18. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.

[2] Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

Shtojcë
Shembuj të zbatimit të konsensusit

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e këtij Interpretimi.

A1 Kjo shtojcë paraqet shtatë shembuj të zbatimit të konsensusit të KIRFN. Shembujt nuk përbëjnë një listë shteruese; janë të mundur edhe modele fakti të tjerë. Çdo shembull supozon se nuk ka kushte të tjera përveç atyre të paraqitur në faktet e shembullit, të cilat do të mund të kërkonin që instrumenti financiar të klasifikohej si një detyrim financiar dhe që instrumenti financiar nuk ka të gjitha tiparet ose nuk plotëson kushtet në paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D të SNK 32.

E drejta e pakushtëzuar për të refuzuar riblerjen (paragrafi 7)

Shembulli 1

Fakte

A2 Statuti i njësisë thotë se riblerjet bëhen sipas gjykimit të lirë të njësisë. Statuti nuk jep detaje te mëtejshme ose kufizime në lidhje me gjykimin. Në historinë e saj, njësia ekonomike asnjëherë nuk ka refuzuar shpërblimin e aksioneve të anëtarëve, edhe pse bordi qeverisës ka të drejtën për të refuzuar.

Klasifikimi

A3 Njësia ka të drejtën e pakushtëzuar për të refuzuar riblerjen dhe aksionet e anëtarëve përbëjnë kapitalin neto. SNK 32 vendos parimet për klasifikimin të cilat bazohen në kushtet e instrumentit financiar dhe vë në dukje se një histori apo qëllim për të bërë pagesa ndaj instrumentit nuk përbën kusht për klasifikimin e tij si detyrim. Paragrafi AG26 i SNK 32 thotë se:

> Kur aksionet e preferuara janë të patërheqshme, klasifikimi i duhur përcaktohet nga të drejtat që ju bashkëngjiten. Klasifikimi bazohet në njohjen e substancës së marrëveshjeve kontraktuale dhe përkufizimeve të një detyrimi financiar dhe instrumenti kapitali. Kur shpërndarjet për tek zotëruesit e aksioneve preferenciale, qofshin këto kumulative ose jo, lihen në gjykimin e lirë të emetuesit, aksionet janë instrumente kapitali. Klasifikimi i një aksioni preferencial si një instrument kapitali apo si detyrim financiar nuk ndikohet nga, për shembull:

(a) historia e shpërndarjes (dhënie dividentësh);

(b) qëllimi për të bërë shpërndarje në të ardhmen;

(c) një ndikim i mundshëm negativ në çmimin e aksioneve të zakonshme të emetuesit nëse shpërndarjet nuk bëhen (për arsye te kufizimeve në pagesën e dividentëve për aksionet e zakonshme nëse dividentët paguhen për aksionet preferenciale);

(d) shuma e rezervave të emetuesit;

(e) pritshmëritë e emetuesit për fitimin ose humbjen për periudhën; ose

(f) aftësia ose paaftësia e emetuesit për të ndikuar në shumën e fitimit ose humbjes për periudhën.

Shembull 2

Fakte

A4 Statuti i njësisë thotë se riblerjet bëhen sipas gjykimit të lirë të njësisë. Megjithatë, statuti më tej thotë se aprovimi i një kërkese për riblerje është automatik përveç situatës kur njësia e ka të pamundur të bëjë pagesa pa shkelur rregulloret vendore në lidhje me likuiditetin dhe rezervat.

Klasifikimi

A5 Njësia ekonomike nuk ka të drejtën e pakushtëzuar (padiskutueshme) të refuzoje riblerjen dhe aksionet e anëtarëve konsiderohen detyrime financiare. Kufizimet e përshkruara më sipër bazohen në aftësinë e njësisë për të shlyer detyrimin. Ato kufizojnë riblerjet vetëm nëse likuiditeti ose kërkesat e rezervave nuk arrihen dhe vetëm deri kur ato të arrihen. Për këtë arsye, këto kufizime, në bazë të parimeve të vendosura nga SNK 32, nuk rezultojnë në klasifikimin e instrumentit financiar si kapital. Paragrafi AG25 i SNK 32 thotë se:

 © Fondacioni i SNRF-ve

Aksionet preferenciale mund të emetohen me të drejta të ndryshme. Për të përcaktuar nëse një aksion preferencial është një detyrim financiar ose një instrument i kapitalit të vet, një emetues vlerëson të drejtat e veçanta që i bashkëngjiten aksionit për të përcaktuar nëse ai shfaq karakteristikën themelore të një detyrimi financiar. Për shembull, një aksion preferencial që lejon riblerjen në një datë specifike apo sipas opsionit të zotëruesit përmban një detyrim financiar sepse emetuesi ka detyrimin të transferojë aktive financiare tek zotëruesi i aksionit. *Paaftësia e mundshme e një emetuesi për të përmbushur një detyrim për të riblerë një aksion preferencial kur është i/e detyruar nga kontrata, qoftë kjo për arsye të mungesës së fondeve, kufizimit ligjor apo fitimeve ose rezervave të pamjaftueshme, nuk mohon detyrimin.* [Shtuar theksimi]

Ndalesa kundër riblerjes (paragrafët 8 dhe 9)

Shembulli 3

Fakte

A6 Një njësi tip kooperativë ka emetuar në të kaluarën aksione për anëtarët e saj në data të ndryshme dhe për shuma të ndryshme si vijon:

(a) 1 janar 20X1 100,000 aksione me NJM10 secilin (NJM1,000,000);

(b) 1 janar 20X2 100,000 aksione me NJM20 secilin (NJM2,000,000 të tjera më vonë, në mënyrë që totali për aksionet e emetuara është NJM3,000,000).

Aksionet janë të tërheqshme sipas kërkesës me çmimin për të cilin u emetuan.

A7 Statuti i njësisë ekonomike thotë se riblerjet kumulative nuk mund të tejkalojnë 20 përqind të numrit më të madh të aksioneve të anëtarëve të emetuara ndonjëherë. Në 31 dhjetor 20X2 njësia ka 200,000 aksione në treg, i cili është numri më i lartë i aksioneve të anëtarëve në treg dhe aksionet nuk janë tërhequr ndonjëherë në të shkuarën. Në 1 janar 20X3 njësia e ndryshon statutin e saj qeverisës dhe rrit nivelin e lejueshëm të riblerjeve kumulative në 25 përqind të numrit më të madh të aksioneve të anëtarëve të emetuara në treg.

Klasifikimi

Para ndryshimit të statutit qeverisës

A8 Aksionet e anëtarëve që janë më tepër në lidhje me ndalimin e riblerjes kundrejt riblerjes janë detyrime financiare. Njësia ekonomike, e tipit kooperativë, e mat këtë detyrim financiar me vlerën e drejtë në njohjen fillestare. Meqë këto aksione riblihen sipas kërkesës, njësia ekonomike e tipit kooperativë mat vlerën e drejtë të këtyre detyrimeve financiare siç kërkohet nga paragrafi 47 të SNRF-13, i cili thotë: "Vlera e drejtë e një detyrimi financiar me një tipar kërkueshmërie (p.sh. një depozitë me afat) nuk është më e vogël se shuma e pagueshme sipas kërkesës ...". Prandaj, njësia ekonomike, e tipit kooperativë klasifikon si detyrimeve financiare shumën maksimale të pagueshme sipas kërkesës në bazë të dispozitave të riblerjes.

A9 Në 1 janar 20X1 maksimumi i shumës së pagueshme sipas kërkesave të nenit të riblerjes është 20,000 aksione me NJM10 secilin dhe për pasojë njësia klasifikon NJM200,000 si detyrim financiar dhe NJM800,000 si kapital. Por, në 1 janar 20X2 për arsye të emetimit të ri të aksioneve me NJM20 secilin, shuma e pagueshme maksimale sipas kërkesave të nenit të riblerjes rritet në 40,000 aksione me NJM20 secilin. Emetimi i aksioneve të tjera me NJM20 krijon një detyrim të ri i cili matet në njohjen fillestare me vlerën e drejtë. Detyrimi pasi këto aksione janë emetuar është 20 përqind i aksioneve totale të emetuara (200,000), të matura me NJM20, ose NJM800,000. Kjo bën të detyrueshme njohjen e një detyrimi shtesë prej NJM600,000. Në këtë shembull fitimi apo humbja nuk njihen. Kështu njësia tani klasifikon NJM800,000 si detyrime financiare dhe NJM2,200,000 si kapital. Ky shembull supozon se këto shuma nuk ndryshojnë midis 1 janar 20X1 dhe 31 dhjetor 20X2.

Pas ndryshimit të statutit qeverisës

A10 Menjëherë pas ndryshimit në strukturën e saj qeverisëse, njësia kooperativë mund të jetë e detyruar të tërheqë një maksimum prej 25% të aksioneve te saj të emetuara në treg ose maksimumin prej 50,000 aksionesh për 20 NJM secilin. Për pasojë, në 1 janar 20X3 njësia ekonomike tip kooperativë klasifikon si detyrim financiar shumën prej 1,000,000 NJM e cila është maksimumi i shumës së pagueshme në momentin e kërkesës sipas kërkesave të kushteve të riblerjes, në përputhje me paragrafin 47 të SNRF 13. Në këtë mënyrë, ajo transferon në 1 janar 20X3 nga kapitali në detyrim financiar një shumë prej 200,000 NJM duke lënë 2,000,000 NJM të klasifikuara si kapital. Në këtë shembull njësia ekonomike nuk njeh ndonjë fitim ose humbje nga transferimi.

Shembulli 4

Fakte

A11 Ligji vendor që qeveris veprimtarinë e kooperativës, ose kushtet e statutit qeverisës së njësisë, ndalon një njësi të riblejë aksione të anëtarëve nëse, duke i riblerë ato, ajo do të reduktonte kapitalin e paguar nga aksionet e anëtarëve nën 75 përqind të shumës më të lartë të kapitalit të paguar nga aksionet e anëtarëve. Shuma më e lartë për një kooperativë të caktuar është NJM1,000,000. Në fund të periudhës raportuese gjendja e kapitalit të paguar është NJM900,000.

Klasifikimi

A12 Në këtë rast 750,000 NJM mund të klasifikohen si kapital i vet dhe 150,000NJM mund të klasifikohen si detyrim financiar. Përveç paragrafëve të cituar tashmë, paragrafi 18(b) i SNK 32 thekson edhe se:

> një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën ta kthejë tek emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare (një 'instrument i kthyeshëm') është një detyrim financiar, përveç rastit kur këto instrumenta klasifikohen si instrumenta të kapitalit të vet në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D. Instrumenti financiar është një detyrim financiar edhe nëse shuma e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare përcaktohet në bazë të një indeksi ose zëri tjetër që ka mundësi që të rritet ose zvogëlohet. Ekzistenca e një mundësie (opsioni) për mbajtësin që të kthejë instrumentin tek emetuesi kundrejt mjeteve monetare ose një aktivi financiar tjetër nënkupton që instrumenti i kthyeshëm plotëson përcaktimin e një detyrimi financiar përveç atyre instrumenteve të klasifikua si instrumenta të kapitalit në përputhje me paragrafët 16A dhe 16B ose paragrafët 16C dhe 16D.

A13 Kufizimi në riblerje i përshkruar në këtë shembull është ndryshe nga kufizimet e përshkruara në paragrafët 19 dhe AG25 të SNK 32. Ato janë kufizime në aftësinë e një njësie për të paguar shumën e detyrimit financiar, d.m.th. ato pengojnë shlyerjen e detyrimit vetëm nëse kushte specifike përmbushen. Në të kundërt, shembulli përshkruan një ndalesë të pakushtëzuar në riblerje pas arritjes së një shume të caktuar, pavarësisht nga aftësia e njësisë për të blerë aksionet e anëtarëve (p.sh. duke njohur nivelin e burimeve të mjeteve monetare, fitimeve, apo rezervave të shpërndara). Në efekt, ndalesa kundër riblerjes privon njësinë nga marrja përsipër e ndonjë detyrimi financiar për të shlyer më shumë se një shumë të caktuar të kapitalit të paguar. Për pasojë, pjesa e aksioneve të cilat janë subjekt i ndalesës ndaj riblerjes nuk konsiderohet detyrim financiar. Edhe pse secili prej aksioneve mund të jetë i tërheqshëm individualisht, një pjesë e totalit të aksioneve janë të patërheqshme në çdo lloj rrethane përveç rasteve të likuidimit të njësisë.

Shembulli 5

Fakte

A14 Faktet e këtij shembulli janë shtruar në shembullin 4. Për më tepër, në fund të periudhës raportuese, kërkesat e detyrueshme të likuiditetit brenda juridiksionit përkatës i ndalojnë njësisë blerjen e aksioneve të anëtarëve përveç rastit kur zotërimet e mjeteve monetare dhe investimeve afatshkurtra janë më të mëdha se një shumë e specifikuar. Efekti i këtyre kërkesave të likuiditetit në fund të periudhës raportuese është se njësia nuk mund të paguajë më shumë se NJM50,000 për të tërhequr aksionet e anëtarëve.

Klasifikimi

A15 Ashtu si në shembullin 4, njësia klasifikon NJM750,000 si kapital dhe NJM150,000 si detyrim financiar. Kjo ndodh për shkak se shuma e klasifikuar si detyrim financiar bazohet mbi të drejtën e pakushtëzuar të njësisë për të refuzuar riblerjen dhe jo mbi kufizime të kushtëzuara të cilat nuk lejojnë riblerjen vetëm nëse likuiditeti ose kushte të tjera nuk përmbushen dhe vetëm deri në kohën kur ato përmbushen. Kërkesat e paragrafëve 19 dhe AG25 të SNK 32 aplikohen në këtë rast.

Shembulli 6

Fakte

A16 Statuti qeverisës i njësisë ndalon riblerjen e aksioneve të anëtarëve, përveç se deri në shumën e të ardhurave të marra nga emetimi i aksioneve të reja për anëtarë të rinj apo ekzistues gjatë tre viteve paraprakë. Të ardhurat nga emetimi i aksioneve të anëtarëve përdoren për të blerë sërish aksionet për të cilat anëtarët kanë kërkuar riblerje. Gjatë tre viteve paraprakë, të ardhurat e gjeneruara nga emetimi i aksioneve të anëtarëve kanë qenë NJM12,000 dhe asnjë aksion anëtarësh nuk është riblerë.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Klasifikimi

A17 Njësia klasifikon NJM12,000 të aksioneve të anëtarëve si detyrime financiare. Në mënyrë konsistente me konkluzionet e përshkruara në shembullin 4, aksionet e anëtarëve që janë subjekt i ndalimit të pakushtëzuar kundër riblerjes nuk konsiderohen detyrime financiare. Një ndalim i tillë i pakushtëzuar vlen për një shumë të barabartë me të ardhurat e aksioneve të emetuara përpara tre viteve paraprake, dhe përkatësisht, kjo shumë klasifikohet si kapital. Megjithatë, një shumë e barabartë me të ardhurat nga çfarë do shitje aksionesh të emetuara në tre vitet paraprake nuk është subjekt i ndalimit të pakushtëzuar mbi riblerjen. Rrjedhimisht, të ardhurat nga emetimi i aksioneve të anëtarëve në tre vitet paraprake ngrenë detyrime financiare derisa ato nuk janë më të disponueshme për riblerje të aksioneve të anëtarëve. Si rezultat, njësia ka një detyrim financiar të barabarte me të ardhurat e aksioneve të emetuara gjatë tre viteve paraprake, minus ndonjë riblerje gjatë kësaj periudhe.

Shembulli 7

Fakte

A18 Njësia është një bankë tip kooperativë. Ligji vendor që qeveris veprimtarinë e bankave tip kooperativa thotë se të paktën 50 përqind të totalit të "detyrimeve" (term i përkufizuar në rregullore duke përfshirë llogaritë e aksioneve të anëtarëve) të njësisë duhet të jetë ne formën e kapitalit të paguar të anëtarëve. Efekti i këtij rregulli është që nëse të gjitha detyrimet e kooperativës kanë formën e aksioneve të anëtarëve, ajo është në gjendje t'i tërheqë të gjitha. Në 31 dhjetor 20X1 njësia ka një total detyrimesh prej NJM200,000, prej të cilave NJM125,000 janë llogari të aksioneve të anëtarëve. Kushtet e llogarive të aksioneve të anëtarëve lejojnë zotëruesin t'i kthejë në mjete monetare sipas kërkesës dhe nuk ka kufizime për riblerje në statutin e njësisë.

Klasifikimi

A19 Në këtë shembull aksionet e anëtarëve klasifikohen si detyrime financiare. Kufizimi në riblerje është i ngjashëm me kufizimet e përshkruara në paragrafët 19 dhe AG25 të SNK 32. Ai është një kufizimi i kushtëzuar në aftësinë e një njësie për të paguar shumën e detyrimit financiar, d.m.th. ai pengon shlyerjen e detyrimit vetëm nëse kushte specifike përmbushen. Në mënyrë më specifike, njësia mund të jetë e detyruar të blerje të gjithë shumën e aksioneve të anëtarëve (NJM125,000) nëse i ri paguan të gjitha detyrimet e tjera financiare (NJM 75,000). Për pasojë, ndalesa kundër riblerjes nuk e privon njësinë nga marrja përsipër e një detyrimi financiar për të shlyer më shumë se një numër të caktuar aksioneve të anëtarëve apo një shume të caktuar të kapitalit të paguar. Ajo lejon njësinë vetëm të shtyjë riblerjen derisa një kusht të përmbushet, d.m.th ripagimi i detyrimeve të tjera. Aksionet e anëtarëve, në këtë shembull, nuk janë subjekt i ndalimit të pakushtëzuar ndaj riblerjes dhe për rrjedhojë konsiderohen detyrime financiare.